VENDIM
Nr. 981, datë 25.11.2020

PËR TRANSFERIM FONDI, NGA BUXHETI I VITIT 2020, MIRATUAR PËR MINISTRINË E KULTURËS, PËR QENDRËN KOMBËTARE TË KINEMATOGRAFISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 4, të ligjit nr. 8096, datë 21.3.1996, "Për kinematografinë", të ndryshuar; të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Qendrës Kombëtare të Kinematografisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2020, t'i transferohet fondi prej 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh, në formën e grantit për Akademinë e Filmit dhe Multimedias "Marubi", për mbështetjen e veprimtarive krijuese.
2. Fondi i përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, të përballohet nga buxheti i vitit 2020, miratuar për Ministrinë së Kulturës, artikulli 604.
3. Ngarkohen Ministria e Kulturës dhe Qendra Kombëtare e Kinematografisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama